



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DECANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECAN



Drejtoria e Arsimit  
Nr.07-Zyrtarisht  
23.11.2023

Në bazë nenit 67, 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Deçan, shpall:


**KONKURS**  
( Për plotësimin e vendeve të lira të punës )

**Institucioni:** Komuna e Deçan  
**Drejtoria:** Drejtoria e Arsimit

**Titulli i vendit të punës:**

1. Mësimdhënës i/e Fizikës në SHFMU "Rexhep Kadrija" në Rastavic (10 orë),  
SHFMU "Ardhmëria" në Beleg (8 orë),  
- Numri i Pozitave: (1)  
- Periudha e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (Vend i Lirë – 18 orë);
  
2. Pedagog i/e shkolle në SHFMU "Isa Boletini" në Isniq dhe shkolla tjera  
- Numri i Pozitave: (1)  
- Kohëzgjatja e kontratës: Më kohë të pacaktuar (Vend i Lirë).

**Lloji i Pozitës:** Nëpunës i Shërbimit Publik  
**Titulli i mbikëqyrësit:** Drejtori i Institucionit



**Detyrat Kryesore të mësimdhënësit/ës:**

1. Misioni dhe detyra e mësimdhënësit është të zhvillojë te nxënësi qëndrim, njoħuri, shkathtesi, dije dhe t'i japë informata sa më të sakta dhe korrekte në pikëpamje shkencore, kulturore e morale;
2. Mësimdhënësi është përgjegjës për edukimin dhe formimin korrekt të nxënësve me normat dhe sjelljet e shëndosha morale;
3. Të realizojë planin dhe programin e paraparë edukativ e arsimor, të respektojë rregullat e disiplinës, orarin e mësimit dhe të kërkoi nga nxënësit të kenë sjellje korrekte;
4. Të vishet në përputhje me kodin etik të veshjes dhe me normat pedagogjike-arsimore të sistemit arsimor të Republikës së Kosovës. Në procesin mësimor mësimdhënësi ka për detyrë të mbajë uniformën e shkollës që e ka zgjedhur Këshilli Drejtues i Shkollës;
5. Përveç procesit të rregullt mësimor, mësimdhënësi organizon takime të veçanta me grupe nxënësish ose me paralele të caktuara, për tematika dhe objektiva specifike, që do t'u shérbenin nevojave që kanë nxënësit për mësim plotësues ose për mësim shtesë;

6. Mësimdhënësi harton planin vjetor dhe mëjor, përgatit planin ditor, i cili duhet të jetë analistik, racional dhe të pasqyrojë teknologjitet bashkëkohore të mësimdhënies, punën në grupe, punën individuale, të mësuarit aktiv e krijues, bën vlerësimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe në raste të veçanta përgatit edhe PIA-n;
7. Mësimdhënësi duhet të jetë udhërrëfyes dhe t'i ndihmojë nxënësit në përdorimin e kompjuterëve, projektorit, veglave muzikore dhe pajisjeve të tjera, të përgatisë orët e mësimit me demonstrime e me mjete konkrete: CD, DVD, tabela, vizatime etj.;
8. Mësimdhënësi mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e orendive dhe pajisjeve në klasat e mësimit, në laboratorë dhe në kabinete. Në rast të shkatërimit ose dëmtimit, duhet të raportojë menjëherë te drejtori i shkollës, në të kundërtën do të detyrohet të paguajë vetë dëmin e shkaktuar;
9. Mësimdhënësi mban përgjegjësi për praninë e nxënësve në mësim, evidentimin e mungesave sipas kërkesave dhe rregullave të caktuara nga MASHT;
10. Mësimdhënësi vendos a duhet të lejojë nxënësin mos të jetë prezent në orën e mësimit, në rastet që i konsideron të arsyeshme; me këtë rast nxënësi shënohet në rubrikën e mungesave me shënimin "me leje" anash;
11. Mësimdhënësi nuk ka të drejtë ta largojë nga ora mësimore nxënësin i cili nuk i respekton rregullat e sjelljes në orën e mësimit. Nëse problemi nuk mund të menaxhohet, atëherë ai adresohet te drejtori i shkollës apo te bashkëpunëtorët profesional në shkollë (nëse ka).
12. Në rast të mungesës nga mësimi për arsyet që nuk mund të shkojë në klasë pa Ditarin personal dhe Librin e klasës;
13. Mësimdhënësi në procesin mësimor nuk guxon të shkojë në klasë pa Ditarin personal dhe Librin e klasës;
14. Mësimdhënësi patjetër merr pjesë në mbledhjen e Këshillit të mësimdhënësve, të Aktiveve profesionale dhe të Këshillit të klasës;
15. Mësimdhënësi obligohet të marrë pjesë dhe të organizojë aktivitete edukative me nxënës;
16. Mësimdhënësi mban përgjithësi për bazën materiale, didaktike etj, që e ka në ngarkim;
17. Mësimdhënësi duhet detyrimisht t'i kompensojë orët e humbura, pavarësisht nga arsyet e humbjes, të ketë paraqitje të rregullt dhe të jetë korrekt në marrëdhënie me të tjerët;
18. Mësimdhënësi duhet ta zbatojë me përpikëri udhëzimin administrativ të MASHT, që përcakton mënyrën e vlerësimit të nxënësve dhe shkallën e arritshme risë së nxënësve.
19. Mësimdhënësi është i obliguar të paraqitet në shkollë së paku 15 minuta para fillimit të mësimit.

### **Detyrat dhe përgjegjësitet e pedagogut**

1. Të kujdeset për realizimin dhe përparimin e punës edukative-arsimore;
2. Të kontribuojë në tejkalimin e problemeve që shfaqen në shkollë, si tek nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe aktorët e tjerë relevantë;
3. Të ndihmojë në hartimin dhe zbatimin e planit zhvillimor të shkollës;
4. Të koordinojë punën e aktiveve profesionale;
5. Të udhëzojë mësimdhënësit në realizimin e veprimtarisë mësimore për zbatimin e metodologjive bashkëkohore;
6. Të monitoroje (hospitojë) dhe të analizojë procesin mësimor;
7. Të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve;
8. Të ndihmojë nxënësit në njohjen e potencialeve të veta, në socializmin e tyre për tejkalimin e vështirësive në të nxënë;
9. Të përgatit raporte profesionale mëjore dhe vjetore për drejtorin e shkollës;
10. Të angazhohet në dy e më shumë shkolla, sipas nevojës (aty ku numri i nxënësve është i vogël);
11. Të kryejë detyra të tjera, të caktuara nga drejtori dhe ato që janë përcaktuar me akte të tjera normative.

**Kushtet dhe Kualifikimi – Mësimdhënës i/e Fizikës:**

Niveli Master Arsimor (300 ECTS);  
Sistemi katërvjeçar;  
Baçelor katërvjeçar 240 ECTS.

**Kriteret e kualifikimit për Pedagog i/e shkolle:**

Pedagog i shkollës – personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik përkatësisht Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë, (apo siç është rregulluar më UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtoreve profesional).

**Kërkesat e përgjithshme për punësim;**

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotëroj njërin nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
4. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
6. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të përshkruar sipas këtij ligji.

**Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (merret në zyrën për shërbime me qytetar – katin e parë nr.1 ose në web. të komunës-<https://kk.rks-gov.net/decan/sherbimet/formularet/>)
- Rezumeja personale (CV);
- Dokumenti personal(letërnjortimi ose pasaporta);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar te noteri;
- Trajnine (nëse ka);
- Vërtetimin për përvojën e punës (nëse ka);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime nga gjykata kompetente;
- Certifikata e lindjes;

**Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.**

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit kandidatet do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistes me gojë sipas U.A NR 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Sqarim: Në mungesë të kandidatëve me kualifikimet e lartëshenuara, në shprehje vijnë kandidatët me kualifikime të përaferta.

**Aplikacionet merren dhe dorëzohen në formë fizike në zyrën pritëse në katin e parë, Nr.1-Komuna e Deçanit apo ti shkarkojnë në portalin <https://kk.rks-gov.net/decan/sherbimet/formularet/>.**

Në test me shkrim do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit. Aplikacionet e pasafatshme dhe të pakompletuara do të refuzohen.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHTI. Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen DKA-së.

Rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Deçanit <https://kk.rksgov.net/pejëi/dhe> në linkun:<https://kk.rks-gov.net/decan/category/njoftimetshpalljet/l-njoftimet/>

**Afati dhe mënyra e publikimit:**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë në portalin e komunës dhe tabelën e shpalljeve, aplikacionet dorëzohen nga data: 23.11.2023 – 07.12.2023

